




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



## KOMUNA E PRISHTINËS

Në bazë të Vendimit nr. 01.nr.324-1147 të datës, 27.05.2011 të asamblesë komunale dhe pëlqimeve të datës 05.02.2009 me nr Ref. 01/22/09 si dhe 20.04.2012 me nr Ref.ZM – 186/12 të MBPZHR të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës Drejtoria e Bujqësisë, me pëlqimin e Ministrisë Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ( MBPZHR), shpallë ofertë publike:

### OFERTË PUBLIKE

**Për dhënie me qira të vendgjuetive të përbashkëta që shtrihen në territorin e Komunës së Prishtinës**

Bazuar në ligjin për Gjueti Nr. 02/L-53, Neni 34,35 dhe 36 , Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2009 për dhënie në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta, Drejtoria e Bujqësisë, Komuna e Prishtinës shpall **Ofertën Publike** për dhënie në menaxhim me qira të **Vendgjuetive të**

**Përbashkëta:**

**“Prishtina I”, “Prishtina II” dhe Prishtina III”**

#### **1. Informata rreth vendgjuetive të përbashkëta që shtrihen në territorin e Komunës së Prishtinës**

Sipërfaqja e përgjithshme e vend-gjuetive në territorin e Komunës së Prishtinës është 50,311.44 hektar, kurse sipërfaqja për aktivitete të gjuetisë është 38,132.92 hektarë. Me Vendimin 01.nr.324-1147 të datës, 27.05.2011, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës janë themeluar tri vend-gjueti dhe atë:

1. Vend-gjuetia “ **Prishtina I**” me sipërfaqe të përgjithshme prej 26,349.02 hektarë dhe sipërfaqe aktive për gjueti prej .....18,853.20 hektarë;
2. Vend-gjuetia “ **Prishtina II**” me sipërfaqe të përgjithshme prej 11,384.21 hektar dhe sipërfaqe të përshtatshme për gjueti prej .....7,243.52 hektarë, dhe
3. Vend-gjuetia “ **Prishtina III**” me sipërfaqe të përgjithshme prej 12,578.40 dhe sipërfaqe të përshtatshme për gjueti prej.....12,036.20 hektarë.

**Sipërfaqja e përgjithshme e lejuar për zhvillim të gjuetisë është baraz me 38,132.92 hektar.**

## **2. Kushtet e përcaktuara për ofertues sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2009,**

### **Neni 5 janë:**

*Kushtet kryesore – përveç atyre që parashihen me legjislacionin e prokurimit publik, që duhet të plotësohen për marrjen me qira të vendgjuetive të përbashkëta janë:*

1. Dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhimin me kafshë të egra dhe gjueti (kjo vlenë për menaxhuesit e gjertanishëm me gjueti – shoqatat e gjuetisë) nga Federata e Gjahtarëve të Kosovës, si dhe përshkrimin e rezultateve menaxhuese nga vitet paraprake;
3. Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme - për subjektet tjera juridike dhe fizike si në: pylltari, bujqësi, veterinë, turizëm, ekologji;
4. Dëshmi për shërbimin profesional që do të angazhohet në menaxhim, duke përfshirë numrin e të punësuarve - gjuetarë të kualifikuar, roje gjuetie, profesionistë të florës dhe faunës;
5. Programin për synimet e menaxhimit dhe zhvillimit të vendgjuetisë – mbrojtja dhe ruajtja, kultivimi dhe shtimi i kafshëve të egra;
6. Dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është i dënuar ose i ndjekur për vepër penale;
7. Dëshmi që vërtetohet se nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të Kosovës;
8. Dëshmi për posedimin e mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie;
9. Çmimi më i lartë ofertues për qiranë.

### **3. Kriteret e vlerësimit të ofertave**

Oferta e subjektit ofertues i cili i plotëson kriteret e lartëcekura dhe që ka çmimin më të lartë ofertues shpallet fitues i projektit.

Afati për tërheqje të materialit ofertues sipas U.A. 06/2009 është prej datës 13.09.2023 deri më datën 27.09.2023

Materiali ofertues tërhiqet në Objektin e Komunës së vjetër në sportelin e Drejtorisë së Bujqësisë.

Afati për dorëzimin e ofertave: 15 ditë nga shpallja e Ofertës Publike

Hapja e ofertave do të bëhet pas përfundimit të procesit të aplikimit, për kohën dhe vendin do të njoftohen të gjithë aplikuesit.

**SPECIFIKACIONI I NUMRIT TË PËRGJITHSHËM DHE NUMRIT TË LLOGARITUR  
PËR TË GJUAJTUR TË LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR ( KAFSHËVFE DHE  
SHPENDËVE, SI DHE ÇMIMI FILLESTAR I OFERTËS PUBLIKE**

Specifikimi ( pasqyra) e të dhënave dhe llogaritjeve për zhvillimin e procedurës së Ofertës Publike është paraqitur në tabelat në vijim:


<b>VEND-GJUETIA " PRISHTINA I "</b>											
<b>TË DHËNAT BAZË PËR PËRGATITJEN E OFERTËS PUBLIKE TË DHËNIES ME QIRA TË VENDGJUETISË " PRISHTINA I "</b>											
<b>Numri rendor</b>	<b>Lloji i kafshëve/ shpezëve</b>	<b>Fondi Bazë sipas të dhënave nga MBPZHR- DP (FA)</b>	<b>Shtimi</b>	<b>Gjithësejtë (2+3)</b>	<b>Plani i gjuajtjes/ Gjuetia</b>	<b>Humbjet</b>	<b>Gjithësejtë ( 5+6)</b>	<b>Fondi në fund të sezonit (4-7)</b>	<b>Çmimi/ copë/krerë €</b>	<b>Gjithësejtë EURO (€)</b>	<b>Çmimi bazë në Euro për shpallje publike sipas Ligjit për Gjueti, Neni 35, paragrafi 35.2</b>
1	Kaproj	5	3	8	-	2	2	6	600	3,000.00	1,500.00
2	Dhi e egër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Ariu	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Rrëqebulli	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Macja e egër	7	4	11	-	3	3	8	80	560	280
6	Derri	24	7	31	-	6	6	25	400	9,600.00	4,800.00
7	Lepuri	26	18	144	-	13	13	131	25	650	325
8	Ujku	6	4	10	-	2	2	8	150	900	450
9	Dhelpra	34	9	43	-	8	8	35	100	3,400.00	1,700.00
10	Vjedulla	12	3	15	-	2	2	13	15	180	90
11	Thëllënza Fushore	406	27	433	-	28	28	405	15	6,090.00	3,045.00
12	Thëllënza Gurore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
13	Pata - Rosa	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
14	Pëllumbat	35	11	46	-	5	5	51	10	350	175
15	Turtulli	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
16	Sqarhi	35	6	41	-	4	4	37	10	350	175
<b>Gjithësejtë</b>											<b>12,540.00</b>

**A. Lista e fshatrave që gravitojnë në VGJP Prishtina I**

Nr	Fshatrat
1	Matiqan
2	Hajvali
3	Zllatar
4	Novosellë
5	Mramor
6	Busi
7	Slivovë
8	Dragocë
9	Kukavicë
10	Marec
11	Zllash
12	Grashticë
13	Llugar

**A.1. Lista e kafshëve të egra ekzistuese (fondi) 2023**

Nr	Emri i kafshëve të egra	Numri
1	Lepuri ( <i>Lepus europaeus</i> , Pallas.)	131
2	Dhelpra ( <i>Vulpes vulpes</i> , L.)	35
3	Derri i egër ( <i>Sus scrofa</i> , L.)	25
4	Pëllumbi ( <i>Columbia columba</i> , L.)	51
5	Fellanza fushore ( <i>Perdix perdix</i> , L.)	405
6	Fazani ( <i>Phasianus colchicus</i> , L.)	/
7	Vjedulla ( <i>Meles melës</i> , L.)	13
0	<b>Llojet e kafshëve strikt të mbrojtura</b>	
1	Shqarh ( <i>Mustela fiona</i> , Erxleben)	37
2	Macja egër ( <i>Felis silvestris</i> , Schreber)	8
3	Kaprolli ( <i>Capreolus capreolus</i> , L.)	6
4	Ujku ( <i>Canis lupulus</i> , L.)	8



**VEND-GJUETIA " PRISHTINA II "**

**TË DHËNAT BAZË PËR PËRGATITJEN E OFERTËS PUBLIKE TË DHËNIES ME QIRA TË VENDGJUESISË " PRISHTINA I "**

Numri rendor	Lloji i kafshëve/ shpezëve	Fondi Bazë sipas të dhënave nga MBPZHR- DP (FA)	Shtimi	Gjithsejtë (2+3)	Plani i gjuajtjes/ Gjuetia	Humbjet	Gjithsejtë ( 5+6)	Fondi në fund të sezonit	Çmimi/ copë/krerë €	Gjithsejtë EURO (€)	Çmimi bazë në Euro për shpallje publike sipas Ligjit për Gjueti, Neni 35, paragrafi 35.2
1	Kaproj	6	3	9		2	2	7	600	3,600.00	1,800.00
2	Dhi e egër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Ariu	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Rrëqebulli	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Macja e egër	9	4	13	-	3	3	10	80	720	360
6	Derri	22	7	29	-	5	5	24	400	8,800.00	4,400.00
7	Lepuri	127	15	142	-	12	12	130	25	3,175.00	1,587.5
8	Ujku	9	4	13	-	2	2	11	150	1,350.00	675
9	Dhelpra	38	11	49	-	12	12	37	100	3,800.00	1,900.00
10	Vjedulla	-	-	-	-	-	-	-	-		
11	Thëllënza Fushore	408	29	437	-	27	27	410	15	6,120.00	3,060
12	Thëllënza Gurore	-	-	-	-	-	-	-	-		
13	Pata - Rosa	-	-	-	-	-	-	-	-		
14	Pëllumbat	44	14	58	-	13	13	45	10	440	220
15	Turtulli	-	-	-	-	-	-	-	-		
16	Sqarathi	2	2	4	-	1	1	3	10	20	10
<b>Gjithsejtë</b>											<b>14,012.5 Euro</b>

## B. Lista e fshatrave që gravitojnë në VGJP Prishtina II

Nr	Fshatrat
1	Makovc
2	Radoshevcë
3	Siqevë
4	Sharban
5	Rimanishtë
6	Teneshdoll
7	Vranidoll
8	Besi
9	Prugovc
10	Drenocë
11	Lupc
12	Trudë
13	Berrnicë e poshtme
14	Berrnicë e eperme
15	Sinidoll

### B.1. Lista e kafshëve të egra ekzistuese (fondi) 2023

Nr	Emri i kafshëve të egra	Numri
1	Lepuri ( <i>Lepus europaeus</i> , Pallas.)	130
2	Dhelpra ( <i>Vulpes vulpes</i> , L.)	37
3	Derri i egër ( <i>Sus scrofa</i> , L.)	24
4	Pëllumbi ( <i>Columbia columbia</i> , L.)	45
5	Fellanza fushore ( <i>Perdix perdix</i> , L.)	410
6	Fazani ( <i>Phasianus colchicus</i> , L.)	/
7	Vjedulla ( <i>Meles melés</i> , L.)	/
0	<b>Llojet e kafshëve strikt të mbrojtura</b>	
1	Shqarth ( <i>Mustela fiona</i> , Erxleben)	3
2	Macja egër ( <i>Felis silvestris</i> , Schreber)	10
3	Kaprolli ( <i>Capreolus capreolus</i> , L.)	7
4	Ujku ( <i>Canis lupulus</i> , L.)	11






### C. Lista e fshatrave që gravitojnë në VGJP Prishtina III

Nr	Fshatrat
1	Koliq
2	Ballaban
3	Nishec
4	Kegekollë
5	Prapashticë
6	Dabishec
7	Glllogovicë
8	Hajkobilë

### C.1. Lista e kafshëve ekzistuese (fondi) 2023

Nr	Emri i kafshëve të egra	Numri
1	Lepuri ( <i>Lepus europaeus</i> , Pallas.)	129
2	Dhelpra ( <i>Vulpes vulpes</i> , L.)	38
3	Derri i egër ( <i>Sus scrofa</i> , L.)	23
4	Pëllumbi ( <i>Columbia sp.</i> , L.)	42
5	Fellanza fushore ( <i>Perdix perdix</i> , L.)	420
6	Fazani ( <i>Phasianus colchicus</i> , L.)	/
7	Vjedulla ( <i>Meles melës</i> , L.)	14
0	<b>Llojet e kafshëve strikt të mbrojtura</b>	
1	Shqarth ( <i>Mustela fiona</i> , Erxleben)	35
2	Macja egër ( <i>Felis silvestris</i> , Schreber)	9
3	Kaprolli ( <i>Capreolus capreolus</i> , L.)	5
4	Ujku ( <i>Canis lupulus</i> , L.)	9





## Kushtet e përcaktimit të çmimit final të Ofertës Publike

Çmimi fillestar i ofertës publike është llogaritur në bazë të shënimeve dhe llogaritjeve profesionale në tabelat e lartë paraqitura duke u bazuar në Ligjin Nr. 02/L-53 PËR GJUEJINË , Neni 35, paragrafi: 35.2, dhe Listës së çmimeve të tregut për kafshë të egra dhe objekteve teknike përcjellëse në vendgjueti si pjesë e Udhëzimit Administrativ Nr.06/200 për Dhënie në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta.

Prishtinë

13.09.2023

